



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 15 nëntor 2024  
Nr. Ref.:RK 2577/24

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI255/23**

Parashtrues

**Genc Qorri**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës në lëndën  
[C.nr.4671/19] të Gjykatës Themelore në Prishtinë**

### **GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Bajram Ljatifi, gjyqtar  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Genc Qorri me vendbanim në Komunën e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Korab Bokshi, avokat nga Gjakova.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston ndonjë akt konkret të autoriteteve publike, por konteston kohëzgjatjen e procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës me numër [C.nr.4671/19] në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës [C.nr.4671/19] në Gjykatën Themelore. Në lidhje me këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin mëtejme: KEDNJ), si dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 17 nëntor 2023, parashtruesi i kërkesës, përmes postës elektronike, e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 29 nëntor 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KI255/23] caktoi Gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KI255/23] kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu - Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
7. Në të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
9. Më 30 gusht 2024, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që ta njoftojë për procedurën e zhvilluar që nga dita e regjistrimit të lëndës [C.nr.4671/19], në atë gjykatë.
10. Më 9 shtator 2024, Gjykata Themelore e njoftoi Gjykatën në lidhje me procedurën e zhvilluar që nga dita e regjistrimit të lëndës [C.nr.4671/19].
11. Më 30 tetor 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## Përmbledhja e fakteve

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 30 qershor 2005, parashtruesit të kërkesës iu kishin sekuestruar nga Shërbimi Policor i Kosovës (në tekstin e mëtejme: SHPK), të hollat në vlerë prej 9,330.00 (nëntë mijë e treqind e tridhjetë) euro, nën dyshimin për kryerjen e veprës penale “Kontrabandimi me migrant” nga paragrafi 1 i nenit 170 (Kontrabandimi me migrantë) lidhur me nenin 31 (Bashkëkryerja) të Kodit Nr. 04/L-082 Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: ish KPRK).
13. Më 1 korrik 2005, bazuar në procesverbalin mbi pranimin e sendeve të “konfiskuara” nga parashtruesi i kërkesës, rezulton se Hetuesi Policor i SHPK në Podujevë ia dorëzoi sendet e sekuestruara Prokurorit publik në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë, O.H., ndër të tjera edhe të hollat në vlerë prej 9,324.00 (nëntë mijë e treqind e njëzet e katër) euro dhe një fakturë në vlerë prej 6 (gjashtë) eurove.
14. Më 25 qershor 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P.nr. 343/06] refuzoi aktakuzën parashtruesit të kërkesës bazuar në nënparagrafin 1.1. të paragrafit 1 të nenit 389 (pa titull) të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejme: KPPK) për shkak se prokurorja e shtetit kishte hequr dorë nga ndjekja penale pas hapjes së shqyrtimit gjyqësor si rezultat i parashkrimit të ndjekjes së veprës penale, pas rikualifikimit të saj.
15. Më 11 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij, parashtrroi kërkesë në Prokurorinë Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore) për lëshimin e urdhrit për kthimin e shumës përkohësisht të sekuestruar në vlerë prej 9,330.00 (nëntë mijë e treqind e tridhjetë) euro nën dyshimin e kryerjes së veprës penale, për të cilën ishte refuzuar aktakuza në bazë të Aktgjykimit [P.nr. 343/06] të 25 qershorit 2018, të Gjykatës Themelore, aktgjykim i cili ishte bërë i plotfuqishëm më 11 tetor 2018.
16. Më 17 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij, parashtrroi një parashtrësë në Gjykatën Themelore, përmes së cilës i dërgoi numrin e llogarisë bankare gjyqtares në rastin e tij, të lartcekur.
17. Më 17 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij, përsëriti kërkesën në Prokurorinë Themelore për kthimin e shumës përkohësisht të sekuestruar në vlerë prej 9,330.00 (nëntë mijë e treqind e tridhjetë) euro. Në këtë kërkesë, ai theksoi se klientit të tij i duhen mjetet monetare sa më shpejtë sepse është i sëmurë dhe ka nevojë për intervenim kirurgjik.
18. Më 21 janar 2019, Gjykata Themelore përmes Urdhrit [P.nr. 343/06], urdhëroi që: (i) të kthehen sendet, respektivisht para e sekuestruara përkohësisht nga Policia e Kosovës, Stacioni Policor në Podujevë (në tekstin e mëtejme: Policia e Kosovës) më 30 qershor 2005, sipas dy listave të EKSIBITEVE nga oficeri [H.B] me numër të ID. 4928 me nr. të rastit 2005-AF-0891, mbi marrjen e përkohshme të pronës para këto në kartëmonedha në euro sipas listës së parë të Eksibiteve 12x200) dhe (15x100) dhe listës së dytë Eksibitive (51x100), (6x50), (1x20) dhe (1x10) në shumë të përgjithshme prej 9.330,00 € (nëntë mijë e treqind e tridhjetë) euro, si dhe (ii) Policia e Kosovës apo Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar (në tekstin e mëtejme: AAPSK) që t'i kthejë parat në shumën prej 9.330,00 € (nëntë mijë e treqind e tridhjetë) euro, pronarit të saj, respektivisht parashtruesit të kërkesës përmes mbrojtësit të tij me autorizim, në llogarinë bankare të specifikuar si në dispozitiv të kësaj urdhërese.
19. Në arsyetimin e urdhrit të lartcekur, Gjykata Themelore gjithashtu theksoi vërejtjen se: “Pas kontaktimit me Hetuesin e SHPK-së në Podujevë, [N.TH], përmes postës elektronike është pranuar procesverbali mbi pranimin e sendeve të konfiskuara nga i

pandehuri [G.Q] nën shenjën PP nr. 345-2/2005, i përpiluar në zyrën e prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë me dt. 01.07.2005, nga i cili procesverbal rezulton se vlera e përgjithshme e monedhave të konfiskuara (nga i akuzuari [G.Q] ) në shumën prej 9,324.00 € janë dorëzuar nga hetuesi i SHPK-së – Podujevë [N.TH] me nr ID-4489, Prokurorit të Prokurorisë së Qarkut [O.M] në të cilin procesverbal janë nënshkruar hetuesi dhe prokurori, ashtu që pas pranimit të procesverbalit në fjalë, Prokurorisë Themelore në Prishtinë, i cili është njoftuar i është ekspeduar kërkesa e mbrojtësit së bashku me procesverbalin në fjalë.”

20. Më 24 janar 2019, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij, parashtrroi kërkesë në AAPSK në bazë të Urdhrit [P.nr. 343/06], të 21 janarit 2019 të Gjykatës Themelore, ku theksoi se: *“Ju faleminderojmë paraprakisht për mirëkuptim dhe presim nga ju që të përshpejtoni vendosjen e kësaj çështje sa më shpejtë të është e mundur dhe atë duke vepruar sipas Urdhresës me nr. P.nr. 343/06 të datës 21.01.2019.”*
21. Më 4 shkurt 2019, AAPSK përmes përgjigjes në kërkesën e 24 janarit 2019 të parashtruesit të kërkesës, e informoi përfaqësuesin e tij si në vijim: *“Më lejoni të ju informoj se Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të konfiskuar nuk mund të bëjë kthimin e mjeteve monetare pasi të njëjtat nuk i ka pranuar dhe nuk i ka në administrimin”.*
22. Më 25 maj 2019, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij, parashtrroi kërkesë në Prokurorinë Themelore që t’i kthejë shumën përkohësisht të sekuestruar në vlerë prej 9,330.00 (nëntëmijë e treqind e tridhjetë) euro, të cilës ia bashkëngjiti edhe numrin e llogarisë bankare.
23. Më 5 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij, përsëriti kërkesën e tij në Prokurorinë Themelore që t’i kthejë shumën përkohësisht të sekuestruar në vlerë prej 9,330.00 (nëntëmijë e treqind e tridhjetë) euro, ku ndër të tjera, theksoi, se: *“Lidhur me këtë çështje gadi nuk kemi lënë adresë relevante pa iu drejtuar. [...] Andaj, tani iu drejtohem Juve si Kryeprokuror që të hulumtohet kjo çështje dhe të hollat e z. Qorri [parashtruesit të kërkesës] të kthehen”.*
24. Më 17 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij, parashtrroi kërkesë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit që t’i kthehet shuma përkohësisht e sekuestruar në vlerë prej 9,330.00 (nëntëmijë e treqind e tridhjetë) euro. Në këtë kërkesë, ndër të tjera, parashtruesi theksoi se *“JU LUTEMI QË ZYRA E KRYEPROKURORIT TË SHTETIT TË I JEP URDHËR PROKURORISË THEMELORE QË PARAT TË GJENDEN DHE TË KËTHEHEN OSE QË TË MERRËN MASA LIGJORE NËSE ATO JANË HUMBUR APO “HUMBUR”.*”
25. Më 16 gusht 2019, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit përmes shkresës [PPN.nr.146] e informoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës që ka pranuar dy parashtrësia në lidhje me kthimin e parave të sekuestruara nga Policia e Kosovës nga parashtruesi, dhe se në lidhje me këtë pas shqyrtimit të tyre, ia kanë dërguar në kompetencë U.D. Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore, me kërkesë që ta regjistrojnë si rast të ri dhe t’i fillojnë hetimet paraprake në mënyrë që të sqarohet kjo çështje.
26. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij, parashtrroi një *“parashtrësë-urgjencë”* në Prokurorinë Themelore, ku theksoi se: *“Lidhur me çështjen e z. [G.Q] iu kamë drejtuar më shumë herë e nuk kam pranuar asnjë njoftim deri tash. Edhe një herë po Ju drejtohem që të më njoftoni lidhur me kërkesat e paraqitura, përkatësisht që të ndërmerremëni veprime për kthimin e shumës prej 9930 € klientit [G.Q] nga Gjakova. Po Ju dërgoj në shtesë njoftimin e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, të Prokurorës z/jës [S.M] PPN.nr. 146/19 dt/ 16.08.2019.*

27. Më 4 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij, parashtrroi "kërkesën e V-të (E PESTË)" në Prokurorinë Themelore që t'i kthejë shumën përkohësisht të sekuestruar në vlerë prej 9,330.00 (nëntë mijë e treqind e tridhjetë) euro.
28. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës në cilësinë e kreditorit parashtrroi propozim për përmbarimin e Urdhrit [P.nr. 343/06] të 21 janarit 2019, të Gjykatës Themelore të përmbaruesi privat, duke iniciuar kështu procedurën e përmbarimit të këtij urdhri kundër debitorëve: (i) Këshilli Prokurorial i Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPK); (ii) Policisë së Kosovës në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme; dhe (iii) AAPSK-së në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
29. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 18 tetor 2019, përmbaruesi privat lëshoi Urdhrit [P.nr.974/19] për lejimin e përmbarimit të Urdhrit [P.nr. 343/06] të 21 janarit 2019, të Gjykatës Themelore në bazë të Aktgjykimit [P.nr.343/06] të 25 qershorit 2018 të Gjykatës Themelore, me kërkesën që të bëhet kthimi i sendeve – parave të sekuestruara nga Policia e Kosovës në vlerën prej 9,330.00 (nëntë mijë e treqind e tridhjetë) euro, me kamatë ligjore prej 8% (tetë përqind), duke filluar nga dita e sekuestrimit të të hollave deri në pagesën definitive.
30. Në të njëjtën ditë, debitori KPK parashtrroi prapësim kundër Urdhrit [P.nr.974/19] për lejimin e përmbarimit të përmbaruesit privat dhe ka kërkuar që i njëjti të anulohet si i pabazuar.
31. Më 24 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës tërhoqi propozimin për përmbarim ndaj debitorëve: (i) Policia e Kosovës në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme; dhe (iii) AAPSK-ja në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, duke lënë aktiv propozimin vetëm ndaj debitorit KPK.
32. Më 29 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës kundërshtoi prapësimin e debitorit KPK, të 18 tetorit 2019.
33. Më 22 tetor 2019, përmbaruesi privat parashtrroi propozimin për përmbarimin e Urdhrit [P.nr. 343/06] të 21 janarit 2019, të Gjykatës Themelore në bazë të Aktgjykimit [P.nr.343/06] të 25 qershorit 2018 të Gjykatës Themelore, në Stacionin Policor të Policisë së Kosovës dhe në AAPSK.
34. Në të njëjtën ditë, Stacioni Policor në Podujevë, ia përcolli propozimin për përmbarim, përmes postës elektronike, Njesisë për Planifikim dhe Vlerësim Operacional në Policinë e Kosovës në Prishtinë, së bashku me procesverbalet e pranimit dorëzimit të të hollave nga Polici hetues te prokurori i çështjes, të gjetura në arkivin e këtij stacioni policor.
35. Më 23 tetor 2023, njoftimi i lartcekur iu përcjellë përmes postës elektronike edhe Drejtorisë së Përgjithshme dhe Sektorit për Çështje Ligjore të Policisë së Kosovës në Prishtinë.
36. Në të njëjtën ditë, Shefi i Sektorit për Çështje Ligjore përmes postës elektronik informoi Sektorin për Planifikim Permanent në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme në Policinë e Kosovës në Prishtinë si në vijim: *"Sektori për Çështje Ligjore e ka shqyrtuar kërkesën e Përmbaruesit privat dhe sqarimin e Shefit të Njesisë për Planifikim dhe Vlerësim Operacional DRP-Prishtinë, Major [G], së të hollat e konfiskuara së bashku me lëndën, Policia e Kosovës (SHPK) i ka dorëzuar tek Policia e Kosovës i ka dorëzuar të hollat e sekuestruara tek Prokuroria e Shtetit (Prokuroria Publike) andaj ju duhet ta informoni përmbaruesin që të drejtohet në Prokurorin kompetente, për të realizuar (të drejtat) e*

*klientit të tij*". Përgjigja e lartcekur iu përcjellë përmes postës elektronike në të njëjtën ditë përmbaruesit privat.

37. Më 29 tetor 2019, AASK përmes postës elektronike informoi përmbaruesin privat në lidhje me propozimin e tij për përmbarim, që të njëjtin nuk mund ta realizojë me arsyetimin se *"AAPSK-ja, nuk mund të bëjë kthimin e mjeteve monetare pasi të njëjtat nuk i ka pranuar dhe nuk i ka në administrim"*. Kësaj përgjigjeje, ia bashkëngjiti edhe përgjigjen e këtij institucioni ndaj kërkesës së përfaqësuesit të parashtruesit, të 4 janarit [shkurtit] 2019.
38. Më 8 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij, parashtroi në KPK një *"Parashtrësë moskëthimi i të hollave të sekuestruara nga Prokuroria Themelore-Prishtinë"*, ku ndër të tjera, e informoi KPK-në për situatën e moskthimit të të hollave nga Prokuroria Themelore bazuar në Urdhrin [P.nr. 343/06] të 21 janarit 2019, të Gjykatës Themelore, si dhe theksoi se: *"Meqë jam drejtuar në shumë adresa dhe përfundimisht duket se të hollat janë "avulluar" në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, duke i njoftuar për këtë ndodhi, për të mos thënë fjalë të rënda, kërkoj nga Ju që të merren masa që qytetarit [G.Q] të i kthehen të hollat, e kush dhe si janë "humbur" ato të holla në Prokurori, çështje që do të duhet intesivisht të veprohet"*.
39. Nga shkresat e lëndës rezultojnë se parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij më 17 dhjetor 2019 parashtroi *"padi detyrimore – për kthimin e të hollave të sekuestruara përkohësisht"* në Gjykatën Themelore kundër palëve në vijim: (i) KPK-së; (ii) Policisë së Kosovës në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejme: MPB); (iii) AAPSK-së në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë (në tekstin e mëtejme: MD); dhe (iv) Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KGJK), me propozimin që të detyrohen KPK dhe Policia e Kosovës, që parashtruesit të kërkesës t'ia paguajnë solidarisht shumën prej 9,324.00 (nëntë mijë e treqind e njëzet e katër) euro në emër të të hollave të sekuestruara më 30 qershor 2005 me kamatë ligjore prej 8% (tetë përqind) nga data e lartcekur deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e aktgjykimit. Padia e lartcekur u regjistrua në Gjykatën Themelore me numrin shënjes [C.nr. 4671/19].
40. Më 20 tetor 2020, Prokuroria Themelore përmes Shënimit Zyrtar [PPN/I nr.151K/19], konsideroi se nuk ka elemente për iniciimin e procedurës penale bazuar në informatat e kërkesës së 5 korrikut 2019, të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës për shkak ndaj personave NN për shkak të veprave penale *"Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar"* nga paragrafi 1 i nenit 422 (Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar) dhe *"Përvetësim në detyrë"* nga neni 425 (Përvetësimi në detyrë) i ish KPRK-së. Nga përmbajtja e këtij shënimi zyrtar rezultojnë se prokurori i cili kishte pranuar të hollat e sekuestruara të parashtruesit të kërkesës më 5 korrik 2005, respektivisht prokurori publik O.M., të cilin i kishte pushuar ushtrimin i funksionit të prokurorit më 29 qershor 2010, më 29 nëntor 2005, të hollat i kishte dorëzuar te prokurori i lëndës XH.D, i cili tashmë është fakt notor se ka vdekur. Në këtë shënim zyrtar, Prokuroria Themelore në fund theksoi se: *"[...] Prokurori vlerëson se ka prova të mjaftueshme se parat janë konfiskuar nga i pandehuri [G.Q] dhe i njëjti ishte liruar nga Gjykata sipas Aktgjykimit P nr. 343/06 e dt. 28.06.2018 mirëpo nuk ekziston asnjë provë se Prokuroria apo Gjykata të i kenë kthyer parat të pandehurit [G.Q]. Andaj në mungesë të provave se cili i dyshuar mund të ketë marrë parat dhe mungesës së qartësive se ku kanë mbetur këto para dhe vërtetimit të vdekjes së personave përgjegjës në atë kohë [O.K], [Xh.D], dhe [T.A] nuk mund të iniciohen procedurë penale dhe ky rast konsiderohet i mbyllur."*
41. Më 29 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij dorëzoi një parashtrësë në Gjykatën Themelore, përmes së cilës propozoi që në shqyrtimin kryesor të lëndës me numër [C.nr. 4671/19], të iniciuar sipas padisë së tij, të 17 dhjetorit 2019, të

nxjerrët si provë edhe Shënimi zyrtar [PPN/I nr.151K/19], i 20 tetorit 2020, të Prokurorisë Themelore, si dhe kërkoi kësaj gjykate që të caktojë seancën përgatitore në këtë çështje juridike.

42. Më 27 nëntor 2020, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPP.nr. 169/20], pranoi si të bazuar prapësimin e debitorit KPK, kundër Urdhrit [P.nr. 974/19] të 18 tetorit 2019 të përmbaruesit privat, me arsyetimin se vendimet gjyqësore (Aktgjykimi [P.nr. 343/06] i 25 qershorit 2018 të Gjykatës Themelore) mbi të cilat është lejuar përmbarimi nuk kanë tiparet e përmbarueshmërisë, sepse nuk është paraparë e drejta e kreditorit, respektivisht detyrimi i debitorit për kthimin e mjeteve.
43. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës në cilësinë e kreditorit ushtroi ankesë kundër Aktvendimit [PPP.nr. 169/20], të 27 nëntorit 2020 të Gjykatës Themelore për pranimin e prapësimit të debitorit KPK.
44. Më 24 tetor 2022, parashtruesi i kërkesës në cilësinë e kreditorit, përmes përfaqësuesit të tij, parashtrroi një parashtrësë në Gjykatën e Apelit me kërkesën që çështja përmbarimore që gjendej në procedurë ankimore sipas ankesës kundër Aktvendimit [PPP.nr. 169/20], të 27 nëntorit 2020 të Gjykatës Themelore, të vendoset sa më parë që është e mundur.
45. Në të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij parashtrroi një parashtrësë/urgjencë në cilësinë e paditësit në Gjykatën Themelore për caktimin e seancës për shqyrtimin e padisë së tij për kthimin e të hollave të sekuestruara përkohësisht, në lëndën me numër [C.nr. 4671/19], duke theksuar se kjo çështje kontestimore ishte iniciuar që afërsisht 3 (tri) vite dhe se sipas tij, *“Për fatin e keq, të hollat e tij janë “avolluar” në duart e insitucioneve shtetërore [...]”*.
46. Më 25 maj 2022, Gjykata e Apelit refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [PPP.nr. 169/20], e 27 nëntorit 2020 të Gjykatës Themelore, me arsyetimin, ndër të tjera, si në vijim:

*“[...]”*

*Gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se urdhëri për përmbarim, i lejuar nga Përmbaruesi Privat [Gj.R], është lejuar mbi bazën e një dokumenti përmbarimor të gjykatës, i cili nuk ka tipare të dokumentit përmbarimor, respektivisht nuk është i përshtatshëm për përmbarim konform nenit 24 dhe 27 të LPP-së. Kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2. të LPP, e cila dispozitë përcakton se “dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurën administrative” dhe përbën bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21 duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragrafi 3 dhe 27 paragrafi 1 të po këtij ligji ku përcaktohet se “dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbarjes së detyrimit”, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave të LPP me rastin e lejimit të prapësimit, nuk qëndrojnë.*

*Prandaj, për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.*

*“[...]”*

## Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

47. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij pretendon shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së si dhe shkelje të së drejtës për pronë, të garantuar përmes paragrafit 1 nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së si rezultat i mos kthimit të të hollave të tij, të sekuestruara në vitin 2005 nga Policia e Kosovës në vlerën prej 9,330.00 (nëntëmijë e treqind e tridhjetë) euro, nën dyshimin e kryerjes së veprës penale “Kontrabandimi me migrant”, për të cilën vepër penale në vitin 2018 ishte refuzuar aktakuza nga Gjykata Themelore me aktgjykim të plotfuqishëm për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.
48. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës pretendon tejzgjatje të procedurës gjyqësore përkitazi me padinë e parashtruar në Gjykatën Themelore, të regjistruar me numrin shënjes [C.nr. 4671/19]. Ai në kërkesën e tij përshkroi mjetet juridike të cilat i kishte ndjekur për realizimin e të drejtës së tij në lidhje me kthimin e të hollave të sekuestruara, përfshirë procedurën përmbarimore dhe kërkesat drejtuar KPK-së deri në parashtrimin e padisë civile në fjalë.
49. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nënvizon, ndër të tjera, se “Janë zhvilluar hetime ndaj [O.M], por si palë nuk kam dyshuar se ato të i ketë vjedh prokurori [O.M], por prokuroria nuk ka ndërmarrë veprime që të i gjejë të hollat. Me këtë çështje është i njohur edhe Prokurori i PTH Prishtinë. Parashtruesi i kërkesës ka qenë në paraburgim. Ky është njeri i varfër por të njëjtit të hollat nuk i kthehen. Veprimet e KGJK dhe Prokurorisë së Shtetit janë arbitrare, paraqesin shkelje nga dispozitat e cituara, për çka parashtruesi i kërkesës kërkon që të udhërohet KGJK dhe Prokuroria e shtetit që parashtruesit të kësaj kërkesë të i kthej të hollat, të konstatoj se i kanë shkelur të drejtat elementare të tij dhe të urdhërohet KGJK, KPK dhe Prokuroria e Shtetit të i kompensoj parashtruesit të kësaj kërkesë kompensimin për dhembjet shpirtërore shumë prej 10.000 eurosh dhe që të urdhëroj Gjykatën Themelore në Prishtinë që të merr në punë lëndën C.nr.4671/19.”

## Përgjigjja Gjykatës Themelore drejtuar Gjykatës

50. Siç është cekur më lart, më 9 shtator 2024, Gjykata Themelore dorëzoi përgjigjen në lidhje me kërkesën e Gjykatës për informata shtesë përkitazi me lëndën [C.nr. 4671/19].
51. Në përgjigjen e saj, Gjykata Themelore theksoi si në vijim:

*“Ju njoftoj se lënda C.nr. 4671/19, është pranuar në gjykatë më datë 20.12.2019. Palë paditëse në këtë çështje është Genc Qorri nga Gjakova, i cili sipas autorizimit që ndodhet në shkresat e lëndës, përfaqësohet nga Korab Bokshi, avokat nga Gjakova. Palë të paditura janë Këshilli Prokurorial i Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës-Policia e Kosovës, Ministria e Drejtësisë-Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës.*

*Gjykata në këtë çështje ka bërë shqyrtimin paraprak të padisë. Më datë 29.07.2021, paditësit i është dërguar vërejtja për pagesën e taksës gjyqësore, ndërsa më datë 02.18.2021, gjykata ka marr aktvendim për përgjigje në padi, i cili së bashku me padinë dhe kopjen e shkresave të lëndës ju është dorëzuar palëve të paditura. Pasi që janë krijuar kushtet ligjore, është caktuar seanca gjyqësore e cila do të mbahet më datë 21.10.2024.*

*Po ashtu ju njoftoj, se numri i lëndëve me të cilat jam e ngarkuar është jashtëzakonisht i madh, andaj edhe lëndët e kësaj natyre caktohen gjithmonë sipas planit të punës.”*



## Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

### KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

#### Neni 31

#### [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.  
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.  
[...]

#### Neni 46

#### [Mbrojtja e Pronës]

“1. E drejta e pronës është e garantuar.  
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.  
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.  
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.  
5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.”

### KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT [e miratuar më 4 nëntor 1950 nga Këshilli i Evropës]

#### Neni 6

#### (E drejta për gjykim të drejtë)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm [...].”

### PROTOKOLLI SHITESË NR. 1 I KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT [i miratuar më 20 mars 1952 nga Këshilli i Evropës]

#### Neni 1

#### (Mbrojtja e pronës)

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

**KODI NR. 04/L-082 KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**Neni 170  
(Kontrabandimi me migrantë)**

*“1. Kushdo që merret me kontrabandim të migrantëve dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri dhjetë (10) vjet.  
[...]*”

**Neni 422  
(Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar)**

*“1. Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.  
[...]*”

**Neni 425  
(Përvetësimi në detyrë)**

*“1. Personi zyrtar, i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, përvetëson pasurinë e cila i është besuar për shkak të detyrës apo pozitës së tij, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.  
[...]*”

**KODI I PËRKOHSHËM I PROCEDURËS PENALE I KOSOVËS**

**Neni 389**

*“Gjykata merr aktgjykim me të cilin akuza refuzohet kur:*

- 1) Paditësi është tërhequr nga akuza nga hapja deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor;*
- 2) I dëmtuari tërhiqet nga propozimi;*
- 3) I akuzuari për të njëjtën vepër është gjykuar me vendim të formës së prerë, është liruar nga akuza ose procedura kundër tij është pushuar me aktvendim të formës së prerë ose*
- 4) Ka kaluar afati i parashkrimit dhe vepra përfshihet në amnisti o falje, ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që përjashtojnë ndjekjen penale.”*

**LIGJI NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE**

**Neni 24  
(Përmbarueshmëria e vendimit)**

*“1. Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarueshem po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.  
2. Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për mosveprim ose veprim, është i përmbarueshem po qe se është bërë i formës së prerë. Organi përmbarues kompetent mund të lejoj një afat shtesë për përmbushjen e obligimeve të debitorit.*”

3. Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.
4. Në bazë të vendimit i cili është bërë i përmbarueshëm vetëm në një pjesë të tij, përmbarimi mund të lejohet vetëm për sa i përket pjesës së tillë.
5. Përmbarimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po qe se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbarimin.”

**Neni 27**  
**(Përshtatshmëria e dokumentit përmbarimor)**

- “1. Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.
2. Në qoftë se me anë të dokumentit përmbarues nuk është caktuar afati për përmbushje vullnetare të detyrimit, afati i tillë do të caktohet me anë të aktvendimit për përmbarimin, dhe urdhrin për përmbarim, për shtatë (7) ditë.
3. Në rastin nga paragrafi 2. i këtij neni, organi përmbarues e cakton përmbarimin e propozuar nëse debitori brenda afatit që i është caktuar për përmbushje vullnetare nuk e përmbushë detyrimin e tij.”

**Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

52. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
53. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton:

Neni 113  
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

54. Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të parashikuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashohin:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

*2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.*

55. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon tejzgjatje të procedurës përkitazi me shqyrtimin e padisë së tij kundër KPK-së, Policisë së Kosovës/MPB, AAPSK-së/MD dhe KGJK-së, për kthimin e të hollave të sekuestruara përkohësisht, të parashtruar më 17 dhjetor 2019 në Gjykatën Themelore, të regjistruar në këtë gjykatë me numër [C.nr. 4671/19].
56. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës specifikon se atij i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, gjegjësisht, *“gjykim në afat të arsyeshëm kohor”* e garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KENDJ-së. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon shkelje të së drejtës në pronë, të garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
57. Përderisa në kontekst të (ii) shterimit të mjeteve juridike, të përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit; dhe (ii) dorëzimin e kërkesës në afatin e përcaktuar me nenin 49 të Ligjit, Gjykata rikujton se çështja e parashtruesit të kërkesës është ende duke u shqyrtuar nga Gjykatën Themelore dhe se i njëjti nuk konteston ndonjë akt konkret të autoriteteve publike, por vetëm kohëzgjatjen e procedurës përkitazi me gjykimin e çështjes së tij brenda një afati të arsyeshëm.
58. Në vijim, përkitazi me pretendimin e tij për moszgjidhje të rastit të tij brenda afatit të arsyeshëm kohor, të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata më tej konstaton se parashtruesi i kërkesës ka saktësuar kërkesën e tij ashtu siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit.
59. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, pika d) e paragrafit (1) dhe paragrafi (2) i rregullit 34 të Rregullores së punës, përcaktojnë që:

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

*[...]*

*(d) Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.*

*[...]*



(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj".

60. Gjykata fillimisht thekson se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "qartazi e pabazuar" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime "të shkallës së katërt"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes"; (iii) pretendime "të pambështetura apo të paarsyetuara"; dhe në fund, (iv) pretendime "konfuze dhe të paqarta" (shih, rastet e GJEDNJ-së [Kemachev kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykim i 24 nëntorit 1994, paragrafi 44 [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005, paragrafi 55; [Mentzen kundër Letonisë](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008, dhe rastet e Gjykatës [Kl04/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 prillit 2021, paragrafi 26; [Kl107/21](#), parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 tetorit 2021, paragrafi 53; dhe [Kl05/23](#) parashtrues *Branislav Gajin*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 janarit 2024, paragrafi 51).
61. Gjykata në vijim, vë në pah se pretendimin e lartcekur të parashtruesit të kërkesës për tejzgjatje të procedurës e cila është duke u zhvilluar pranë Gjykatës Themelore që nga 17 dhjetori 2019, do ta trajtojë nga këndvështrimi i të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke aplikuar në këtë rast edhe parimet dhe kriteret e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ, në të cilin rast Gjykata në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e obliguar që "Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".
62. Në lidhje me të drejtën për nxjerrjen e vendimeve brenda afatit të arsyeshëm kohor, Gjykata i referohet paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, të cilët përcaktojnë që:

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

[...]

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet [...] brenda një afati të arsyeshëm [...].

Neni 6

(E drejta për gjykim të drejtë)

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm ...".



63. Përkitazi me shkeljen e të drejtës kushtetuese lidhur me gjykimin e rasteve brenda afatit të arsyeshëm kohor, të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë gjyqësore, e cila është ndërtuar duke u bazuar në parimet e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet e GJEDNJ-së, *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, nr. 9616/81, Aktgjykim, i 23 prillit 1987; *Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, nr. 8130/78, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, *Mikulić kundër Kroacisë*, nr. 53176/99, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002; *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000; *Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*, nr. 21/1993/416/495, Aktgjykim i 19 shtatorit 1994; *H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 9580/81, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002; *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09 64482/09 12874/10 56935/10 3129/12, Aktgjykim i 1 prillit 2014; *Abdoella kundër Holandës*, nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992, paragrafi 24; *Bock kundër Gjermanisë*, nr. 11118/84, Aktgjykim i 21 shkurtit 1989, paragrafi 49; *Laino kundër Italisë*, nr. 33158/96, Aktgjykim i 18 shkurtit 1999; *Vocaturò kundër Italisë*, nr. 11891/85, Aktgjykim, i 24 majit 1991; *X kundër Francës*, nr. 18020/91, Aktgjykim i 31 marsit 1992). Thënë këtë, rastet e Gjykatës përmes të cilave Gjykata ka afirmuar parimet e vendosura nga GJENDJ dhe të njëjtat i ka aplikuar edhe në rastet për shqyrtim para saj, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet e Gjykatës: *KI07/15*, parashtrues *Shefki Zogiani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 shtatorit 2016; *KI23/16*, parashtrues *Qazim Bytyqi dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 majit 2017;; *KI18/18*, parashtrues *Isuf Musliu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 qershorit 2018; *KI13/19*, parashtrues *Fevzi Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 qershorit 2019; *KI177/19*, parashtrues *NNT "Sokoli"*, Aktgjykim i 16 prillit 2019; *KI135/20*, parashtruese *Hava Behxheti*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 dhjetorit 2020; *KI104/20*, parashtrues *Ejup Koci*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 marsit 2021; *KI183/21*, parashtrues *Ejup Koci*, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 marsit 2022; *KI03/22*, parashtrues *EPS "Trgovina"*, Aktvendim për papranueshmëri i 29 shtatorit 2022; *KI19/21*, parashtrues *Sadik Pllana*, Aktgjykim i 11 gushtit 2022; *KI09/21*, parashtrues *Dragan Mihajloviq*, Aktgjykim i 2 shkurtit 2023, *KI02/22*, parashtrues *"Elektrosever" sh.p.k.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2022.

64. Rrjedhimisht, në pajtim me parimet dhe kriteret e vendosura përmes kësaj praktike gjyqësore, gjatë shqyrtimit të pretendimit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do të merr parasysh: (i) vërtetimin e periudhës së kohëzgjatjes të procedurës në tërësi në gjykatën kompetente, përkatësisht Gjykatën Themelore; (ii) parimet relevante në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës; dhe (iii) arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procedurave në Gjykatën Themelore.

**(i) Periudha që do të merret parasysh**

65. Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikës së saj gjyqësore, ka vlerësuar se përlllogaritja e shtrirjes në kohë të procedurave fillon në momentin kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palëve për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 64; dhe *Poiss kundër Austrisë*, nr.9816/82, Aktgjykim, i 23 prillit 1987, paragrafi 50). Ky proces konsiderohet i përfunduar me nxjerrjen e një vendimi gjyqësor përfundimtar nga një instancë kompetente gjyqësore e fundit (shih rastin e GJEDNJ-së, *Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 74 dhe rastet e Gjykatës: *KI177/19*, parashtrues *NNT "Sokoli"*, cituar më lart, paragrafi 98; *KI183/21*, parashtrues *Ejup Koci*, cituar më lart, paragrafi 74; dhe *KI03/22*, parashtrues *EPS "Trgovina"*, cituar më lart, paragrafi 52).



66. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës më 17 dhjetor 2019 kishte parashtruar “*padi detyrimore – për kthimin e të hollave të sekuestruara përkohësisht*” kundër KPK-së, Policisë së Kosovës/MPB, AAPSK-së/MD dhe KGJK-së, në Gjykatën Themelore, përderisa kërkesën e tij në Gjykatë e ka dorëzuar më 17 nëntor 2023. Në vijim të kësaj, Gjykata vëren se periudha e cila duhet të merret parasysh është 3 (tre) vjet e 11 (njëmbëdhjetë) muaj.

### **(ii) Parimet relevante**

67. Gjykata para se gjithash thekson se, sipas praktikës gjyqësore të konsoliduar të GJEDNJ-së, e cila është reflektuar edhe në praktikën e deritanishme gjyqësore të Gjykatës, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit, duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, përkatësisht kriteret që i referohen: (a) ndërlikueshmërisë së rastit; (b) sjelljes së palëve në procedurë; (c) sjelljes së gjykatës kompetente ose autoriteteve të tjera publike; si dhe (d) rëndësisë së asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest (shih rastet e GJEDNJ-së, *Mikulić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 38; *Frydlander kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 43; dhe *Sürmeli kundër Gjermanisë*, nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006, paragrafi 128; shih gjithashtu rastet e Gjykatës KIO7/15, parashtrues *Shefki Zogiani*, cituar më lart, paragrafët 53-62; KI23/16, parashtrues *Qazim Bytyqi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 58; KI18/18, parashtrues *Isuf Musliu*, cituar më lart, paragrafi 43; KI13/19, parashtrues *Fevzi Hajdari*, cituar më lart, paragrafët 65-72; KI177/19, parashtrues *NNT “Sokoli”*, cituar më lart, paragrafët 96-106; KI104/20, parashtrues *Ejup Koci*, cituar më lart, paragrafi 46; KI135/20, parashtruese *Hava Behxheti*, cituar më lart, paragrafët 39-54 dhe KI183/21, parashtrues *Ejup Koci*, cituar më lart, paragrafi 85, KIO3/22, parashtrues *EPS “Trgovina”*, cituar më lart, paragrafi 54; KI19/21, parashtrues *Sadik Pllana*, cituar më lart, paragrafi 85; dhe KIO9/21, parashtrues *Dragan Mihajloviq*, cituar më lart, paragrafi 54).

### **(iii) Analiza e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës**

68. Ashtu siç është elaboruar edhe më lart, Gjykata vë në pah se parashtruesi i kërkesës padinë e tij në Gjykatën Themelore e ka parashtruar më 17 dhjetor 2019. Në vijim të kësaj, për të konstatuar nëse procedura e zhvilluar pranë Gjykatës Themelore përbën tejzgjatje, Gjykata duhet të merr parasysh faktorët si në vijim: (a) ndërlikueshmërinë e rastit; (b) sjelljen e parashtruesit të kërkesës; (c) sjelljen e autoriteteve relevante gjyqësore; dhe (d) rëndësinë e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin e kërkesës në kontest.
69. Gjykata përsëritë se thelbi i këtij rasti konsiston në faktin se parashtruesit të kërkesës më 30 qershor 2005 iu kishin sekuestruar nga Policia e Kosovës, të hollat në vlerë prej 9,330.00 (nëntë mijë e treqind e tridhjetë) euro, nën dyshimin e kryerjes së veprës penale “*Kontrabandimi me Migrantë*”, e cila aktakuzë, më 25 qershor 2018, u refuzua përmes Aktgjykimit të Gjykatës Themelore si rezultat i parashkrimit të ndjekjes penale, ku ndër të tjerash, u përcaktua që t’i kthehen mjetet e lartcekura monetare parashtruesit të kërkesës. Më 21 janar 2019, Gjykata Themelore po ashtu, me urdhër të veçantë, urdhëroi kthimin e sendeve, respektivisht mjeteve të lartcekura montetare. Që nga 11 tetori 2018, parashtruesi parashtrroi një mori kërkesash pranë Prokurorisë së Shtetit, KPK-së dhe AAPSK-së për kthimin e të hollave të sekuestruara, si dhe zhvilloi një procedurë përmbarimore kundër KPK-së, e cila përfundoi më 25 maj 2022 në Gjykatën e Apelit, e cila vërtetoi aktvendimin e Gjykatës Themelore me të cilën refuzohej përmbarimi i Aktgjykimit dhe urdhrin të Gjykatës Themelore me arsyetimin se i njëjti nuk i kishte tiparet e një dokumenti përmbarues. Më 5 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kishte iniciuar procedurë penale ndaj personave të panjohur në KPK për shkak të veprave penale “*Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar*” dhe



“Përvetësim në detyrë”, për të cilën procedurë, më 20 tetor 2020, Prokuroria Themelore përmes një Shënimi Zyrtar konsideroi se nuk ka elemente për iniciimin e procedurës penale për shkak se prokurori i çështjes në rastin e sekuestrimit të mjeteve monetare të parashtruesit kishte vdekur së bashku me personat e tjerë përgjegjës të cilët do të mund të dëshmonin në këtë rast. Më 17 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar në Gjykatën Themelore edhe një padi kundër KPK-së për kthimin e mjeteve monetare, kohëzgjatjen e së cilës procedurë gjyqësore specifikisht e konteston para Gjykatës Kushtetuese.

70. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se objekt i çështjes në këtë kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës [C.nr.4671/19] në Gjykatën Themelore dhe jo procedurave të tjera.

(a) Ndërlikueshmëria e rastit

71. Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës përmes të cilave ishte theksuar se ndërlikueshmëria e rastit mund të ndërlikohet me çështje të faktit dhe të ligjit por gjithashtu mund të ndërlikohet edhe me përfshirjen e disa palëve në procedurë apo me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta (shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së, [Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë](#), cituar më lart, paragrafi 55; [H. kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), cituar më lart, paragrafi 72; [Humen kundër Polonisë](#), nr. 26614/95, Aktgjykim i 15 tetorit 1999, paragrafi 63; shih rastet e Gjykatës, KI18/18, parashtrues *Isuf Musliu*, cituar më lart, paragrafi 45; dhe KI104/20, parashtrues *Ejup Koci*, cituar më lart, paragrafi 48).
72. Në rastin konkret, Gjykata vëren se rasti i parashtruesit të kërkesës ndërlikohet me çështje kontestimore, ku parashtruesi përmes një padie kundër KPK-së, Policisë së Kosovës/MPB, AAPSK-së/MD dhe KGJK-së, ka kërkuar kthimin e mjeteve monetare, të cilat ia kishte sekuestruar Policia e Kosovës/Prokuroria e Shtetit nën dyshimin e kryerjes së veprës penale “*Kontrabandimi me migrantë*”, në përputhje me urdhrin e Gjykatës Themelore për kthimin e këtyre mjeteve si rezultat i refuzimit të aktakuzës për veprën penale të lartcekur.
73. Gjykata po ashtu vë në pah se në këtë rast janë ndërmarrë edhe disa lloje të procedurave të tjera gjyqësore siç është procedura përmbarimore dhe penale. Si rezultat i iniciimit të procedurës penale, Prokuroria e Shtetit kishte ndërmarrë një hetim me ç’rast kishte ardhur në përfundim se prokurori përgjegjës në çështjen e parashtruesit të kërkesës si dhe dëshmitarët potencial në këtë rast kanë vdekur, gjë që e pamundëson hetimin e mëtejshëm penal. Në këtë kontekst, rasti i cili është në shqyrtim e sipër është mjaftueshëm i ndërlikuar në kuptim të mbledhjes së provave.

(b) sjellja e parashtruesit të kërkesës

74. Gjykata konsideron se sjellja e parashtruesve përbën një fakt objektiv që nuk mund t’u atribuohet gjykatave dhe që duhet marrë parasysh konstatimin, nëse procedurat vazhduan më gjatë se sa afati i arsyeshëm kohor, i garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së (shih në këtë kuptim rastet e GJEDNJ-së, [McFarlane kundër Irlandës](#), nr. 31333/06, Aktgjykim i 10 shtatorit 2010, paragrafin 148; [Eckle kundër Gjermanisë](#), rast i cituar më lart, paragrafi 82; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI07/15, parashtrues *Shefki Zogiani*, cituar më lart, paragrafi 55).
75. Lidhur me sjelljen e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pas padisë së tij, të parashtruar më 17 dhjetor 2019 në Gjykatën Themelore, parashtruesi



i kërkesës në të njëjtën gjykatë, më 29 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij dorëzoi një parashtrësë, përmes së cilës propozoi që në shqyrtimin kryesor të lëndës me numër [C.nr. 4671/19], të nxjerrët si provë edhe Shënimi zyrtar [PPN/I nr.151K/19], i 20 tetorit 2020, të Prokurorisë Themelore, si dhe i kërkoi kësaj gjykate që të caktojë seancën përgatitore në këtë çështje juridike.

76. Përveç kësaj, nga shkresat e lëndës rezulton se më 24 tetor 2022, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij parashtrroi edhe një parashtrësë/urgjencë në cilësinë e paditësit në Gjykatën Themelore për caktimin e seancës për shqyrtimin e padisë së tij për kthimin e të hollave të sekuestruara përkohësisht, në lëndën me numër [C.nr. 4671/19], duke theksuar se kjo çështje kontestimore ishte iniciuar që afërsisht 3 (tri) vite dhe se sipas tij, *“Për fatin e keq, të hollat e tij janë “avolluar” në duart e insitucioneve shtetërore [...]”*.
77. Në vijim dhe bazuar në veprimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës që nga dita e parashtrimit të padisë së tij në Gjykatën Themelore [17 dhjetor 2019] deri në ditën e parashtrimit të kërkesës së tij të tanishme në Gjykatë [17 nëntor 2023], Gjykata konsideron se veprimet e tilla procedurale nuk mund të kenë ndikuar në vonesën e Gjykatës Themelore në shqyrtimin e padisë së tij.

*(c) sjellja e autoriteteve relevante*

78. Gjykata vë në dukje qëndrimin parimor të GJEDNJ-së se paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së kërkon nga shtetet kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore, në mënyrë të atillë që autoritetet kompetente të përmbushin kërkesat e nenit në fjalë, duke përfshirë edhe detyrimin për të shqyrtuar çështjet brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë](#), cituar më lart, paragrafi 91; [Abdoella kundër Holandës](#), cituar më lart, paragrafi 24, [Mishgjoni kundër Shqipërisë](#), 18381/05, Aktgjykim, i 7 dhjetorit 2010).
79. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton edhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të cilën e kishte konfirmuar në rastin e saj KI183/21, ku kishte theksuar se nuk mund të merret në konsideratë arsyetimi i gjykatave për mbingarkesën me lëndë të pazgjidhura (shih rastet e GJEDNJ-së, [Vocaturò kundër Italisë](#), cituar më lart, paragrafi 17; dhe [Cappello kundër Italisë](#), nr. 12783/87, Aktgjykim i 24 janarit 1992, paragrafi 17). GJEDNJ, megjithatë kishte theksuar se mbingarkesa e përkohshme e rasteve nuk përfshin përgjegjësinë e shteteve kontraktuese, me kushtin që ato, me shpejtësinë e domosdoshme, ndër marrin veprime korigjuese që të përballen me një situatë të tillë të veçantë (shih rastet e GJEDNJ-së, [Buchholz kundër Gjermanisë](#), nr. 7759/77, Aktgjykim, i 6 majit 1981, [Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës](#), nr. 8737/79, Aktgjykim, i 13 korrikut 1983, paragrafi 29, po ashtu shih rastin e Gjykatës KI183/21, parashtrues [Ejup Koci](#), cituar më lart, paragrafi 98).
80. Në vijim, GJEDNJ ka specifikuar se: *“Metodat që mund të konsiderohen, si të përshtatshme dhe përkohshme, përfshijnë zgjedhjen për të trajtuar rastet sipas një radhe të veçantë, bazuar jo vetëm në datën kur ato janë parashtruar, por duke marrë në konsideratë shkallën e tyre të urgjencës dhe të rëndësisë dhe, në veçanti, në atë që është në rrezik për palët e interesuara”* (shih rastin [Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës](#), cituar më lart, paragrafi 29).
81. Lidhur me sjelljen e autoriteteve relevante dhe kompetente, Gjykata, pas dorëzimit të kërkesës së parashtruesit të kërkesës në Gjykatë, më 30 gusht 2024 ka njoftuar Gjykatën Themelore përkitazi me kërkesën e parashtruesit të kërkesës, dhe të njëjtës i ka kërkuar që të njoftojë Gjykatën lidhur me procedurën e zhvilluar në Gjykatën Themelore, që nga dita e regjistrimit të lëndës [C.nr. 4671/19] në këtë gjykatë.

82. Gjykata thekson përgjigjen e Gjykatës Themelore përkitazi me procedurën e zhvilluar për lëndën [C.nr. 4671/19], e cila njofton se pas pranimit të kësaj lënde më 20 dhjetor 2019, “[...] Gjykata [Themelore] në këtë çështje ka bërë shqyrtimin paraprak të padisë. Më datë 29.07.2021, paditësit i është dërguar vërejtja për pagesën e taksës gjyqësore, ndërsa më datë 02.08.2021, gjykata ka marr aktvendim për përgjigje në padi, i cili së bashku me padinë dhe kopjen e shkresave të lëndës ju është dorëzuar palëve të paditura. Pasi që janë krijuar kushtet ligjore, është caktuar seanca gjyqësore e cila do të mbahet më datë 21.10.2024.  
Po ashtu ju njoftoj, se numri i lëndëve me të cilat jam e ngarkuar është jashtëzakonisht i madh, andaj edhe lëndët e kësaj natyre caktohen gjithmonë sipas planit të punës.”
83. Gjykata po ashtu vë në pah se që nga pranimi i lënde në Gjykatën Themelore më 20 dhjetor 2019, sipas përgjigjes së të njëjtës, janë ndërmarrë veprimet si vijon: (i) ka bërë shqyrtimin paraprak të padisë; (ii) më 29 korrik 2021, ia ka dorëzuar parashtruesit të kërkesës vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore; (iii) më 2 gusht 2021, ka marrë aktvendim për përgjigje në padi, të cilën së bashku me padinë dhe kopjen e shkresave të lëndës ia ka dorëzuar palëve të paditura; si dhe (iv) ka caktuar një seancë gjyqësore që pritet të mbahet më 21 tetor 2024.
84. Gjykata po ashtu vëren se gjyqtarja e ngarkuar me këtë lëndë në përgjigjen e saj thekson se numri i lëndëve me të cilat është e ngarkuar është “jashtëzakonisht i madh” dhe se lëndët e kësaj natyre caktohen sipas planit të punës.
85. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata rikujton përgjigjen e KGJK-së, të 7 marsit 2022, në pyetjet e parashtruara nga ana e Gjykatës në rastin KI183/21, përkitazi me numrin e madh të lëndëve të prapambetura dhe strategjisë për zvogëlimin e tyre, e cila thekson se me qëllim të uljes së numrit të lëndëve dhe shqyrtimit të tyre në afat të arsyeshëm kohor kishin ndërmarrë veprimet në vijim: (i) kishte hartuar planin strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025, i cili plan rezulton të jetë miratuar më 8 qershor 2022 nga KGJK; (ii) kishte filluar procesin e rekrutimit të gjyqtarëve të rinj, nga i cili proces rezulton të jenë dekretuar 48 (dyzet e tetë) gjyqtarë të rinj, ndërsa në vitin 2024, ishin dekretuar edhe 46 (dyzet e gjashtë) gjyqtarë të tjerë; (iii) kishte filluar procesin e rekrutimit të bashkëpunëtorëve profesional; si dhe (iv) kishte filluar përditësimin e kornizës normative që ndërlidhet me normën e gjyqtarëve, nga çka rezulton se më 7 prill 2023, KGJK kishte miratuar Rregulloren Nr. 03/2023 për normën e punës së gjyqtarëve (shih rastin e Gjykatës 183/21, parashtrues *Ejup Koci*, cituar më lart, paragrafët 57 dhe 105-111).
86. Rrjedhimisht, marrë për bazë procedurën e zhvilluar në Gjykatën Themelore, përfshirë edhe caktimin e seancës gjyqësore që pritet të mbahet më 21 tetor të këtij viti, si dhe periudhën kohore prej 3 (tre) viteve e 11 (njëmbëdhjetë) muajve që nga regjistrimi i kësaj lënde te gjyqtari përkatës në Gjykatën Themelore [më 17 dhjetor 2019] deri në regjistrimin e kërkesës KI255/23 në Gjykatë [17 nëntor 2023], Gjykata nuk mund të konsiderojë se e njëjta është treguar tërësisht pasive gjatë shqyrtimit të padisë së parashtruesit të kërkesës. Po ashtu, marrë parasysh veprimet e fundit të KGJK-së për zgjidhjen e lëndëve të prapambetura, Gjykata konsideron se janë duke u marrë veprimet të nevojshme që rastet e pazgjidhura të shqyrtohen dhe trajtohen me prioritet. Megjithatë, Gjykata thekson se gjykatat e rregullta kanë parasysh obligimin kushtetues dhe ligjor, që çështjet t'i finalizojnë brenda një afati të arsyeshëm kohor.

(c) Rëndësia e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest

87. Lidhur me kriterin e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila sqaron se një kategori e rasteve



kërkon zgjidhje të veçantë ekspeditive. Sipas kësaj praktike, shembuj që kërkojnë kujdes të veçantë dhe zgjidhje me prioritet janë rastet që ndërlidhen me statusin dhe zotësinë civile të personave fizikë siç është divorci, kujdestaria e fëmijëve dhe marrëdhënia prind-fëmijë (shih rastet e GJEDNJ-së, *Bock kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 49, *Laino kundër Italisë*, cituar më lart, paragrafi 18, *Mikulić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 44, *Tsikakis kundër Gjermanisë*, nr. 1521/06, Aktgjykim i 10 shkurtit 2011, paragrafët 64 dhe 68, *Hokkanen kundër Finlandës*, nr. 19823/92, Aktgjykim i 23 shtatorit 1994, paragrafi 72; *Niederböster kundër Gjermanisë*, nr. 39547/98, Aktgjykim i 27 majit 2003, paragrafi 39); rastet lidhur me kontestet nga marrëdhënia e punës (shih rastet e GJEDNJ-së, *Frydlender kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 45, *Vocaturò kundër Italisë*, cituar më lart, paragrafi 17); rastet e parashtruesve që vuajnë nga “sëmundje të pashërueshme” dhe kanë “pritje të reduktuar të jetëgjatësisë” (shih rastet e GJEDNJ-së, *X kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 47; *A. dhe të tjerët kundër Danimarkës*, nr. 20826/92, Aktgjykim i 22 janarit 1996, paragrafët 78-8), si dhe rastet rreth të drejtës për arsim (shih rastin e GJEDNJ-së, *Oršuš dhe të tjerët kundër Kroacisë*, nr. 15766/03 Aktgjykim i 16 marsit 2010, paragrafi 109).

88. Thënë këtë, Gjykata vlerëson se bazuar në praktikën e konsoliduar gjyqësore të GJEDNJ-së, çështja që ngre parashtruesi i kërkesës nuk është çështje që kërkon “kujdes të posaçëm” (*particular diligence*) siç janë shembujt e lartcekur të vlerësuar nga GJEDNJ si kategori e çështjeve që kërkojnë zgjidhje e prioritet.

*Përfundim në lidhje me pretendimin për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës*

89. Nga sa më sipër, Gjykata duke aplikuar parimet e lartcekura të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të afirmuara edhe përmes praktikës gjyqësore të vet Gjykatës në rrethanat e parashtruesit të kërkesës rikujton se i njëjti më 17 dhjetor 2019 kishte parashtruar padi për kthimin e mjeteve monetare të sekuestruara përkohësisht nga Policia e Kosovës/Prokuroria e Shtetit me rastin e arrestimit të tij në vitin 2005 nën dyshimin e kryerjes veprës penale “Kontrabandim me migrantë”, e cila aktakuzë iu refuzua me aktgjykim të Gjykatës Themelore, i cili mori formën e prerë në vitin 2018 dhe i cili aktgjykim urdhëroi kthimin e këtyre mjeteve te parashtruesi i kërkesës. Në lidhje me rastin konkret ishin zhvilluar disa procedura gjyqësore, por parashtruesi e konteston vetëm kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore në lidhje me shqyrtimin e padisë së lartcekur, e cila është ende duke u shqyrtuar pranë gjykatës së shkallës së parë, gjegjësisht, në Gjykatën Themelore.
90. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se nga vlerësimi i procedurës së zhvilluar në rastin e parashtruesit të kërkesës për shqyrtimin e padisë së tij të 17 dhjetorit 2019, nuk rezulton se të njëjtat janë të paarsyeshme. Më konkretisht, Gjykata vë në pah se që nga dita e paraqitjes së padisë së tij në Gjykatën Themelore, përkatësisht më 17 dhjetor 2019 deri tek dorëzimi i kërkesës së tij në Gjykatë më 17 dhjetor 2023 kanë kaluar 3 (tre) vjet e 11 (njëmbëdhjetë) muaj. Gjykata vlerëson se çështja e parashtruesit të kërkesës është mjaftueshëm e ndërlidhur marrë parasysh mbledhjen e provave për shkak se personat përgjegjës për ruajtjen e mjeteve monetare në fjalë tashmë kanë vdekur sipas Shënimit Zyrtar të Prokurorisë së Shtetit. Gjykata konsideron gjithashtu se çështja e parashtruesit të kërkesës nuk hyn në kategorinë e çështjes e cila kërkon një zgjidhje të përsheptuar. Gjykata po ashtu vlerëson se veprime e parashtruesit nuk kanë ndikuar në vonesën e shqyrtimit të lëndës së tij si dhe bazuar në përgjigjen e Gjykatës Themelore përkitazi me procedurën e zhvilluar të lëndës së parashtruesit të kërkesës, rezulton se e njëjta nuk ka qenë pasive por ka komunikuar me parashtruesin, së fundmi përmes caktimit të seancës shqyrtuese e cila pritet të mbahet më 21 tetor 2024.
91. Në përfundim, Gjykata konstaton se kohëzgjatja e procedurës në Gjykatën Themelore prej 3 (tre) viteve e 11 (njëmbëdhjetë) muajve përkitazi me shqyrtimin e lëndës me

numër [C.nr. 4671/19] gjatë procedurës së zhvilluar në Gjykatën Themelore të parashtruesit të kërkesës nuk mund të konsiderohet e paarsyeshme.

92. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh kriteret e lartcekura të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të afirmuara edhe përmes praktikës gjyqësore të vet Gjykatës përkitazi me të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës lidhur me tejzgjatjen e procedurës dhe moszgjidhjen brenda një afati të arsyeshëm të lëndës [C.nr. 4671/19], është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese në *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”* dhe duhet të shpallet i papranueshëm në pajtim me paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.
93. Në fund, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, përveç pretendimeve të trajtuara më lart, pretendon edhe shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës. Megjithatë, në këtë kontekst i njëjti vetëm përmend këtë nen, por nuk elaboron dhe shtjellon më tej si dhe pse ka ardhur deri te shkelja e këtij neni nga ana e gjykatave të rregullta. Siç është shprehur edhe në rastet e tjera, Gjykata përsërit qëndrimin e saj se vetëm përmendja dhe citimi i neneve të Kushtetutës apo instrumenteve të tjera ndërkombëtare, nuk mjafton për të ngritur pretendime për shkelje të të drejtave kushtetuese. Kur pretendon për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, parashtruesi duhet të paraqesë dëshmi dhe argumente bindëse, për të dëshmuar shkeljet e supozuara (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues, *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; [KI166/20](#) parashtrues *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2020, paragrafi 52; [KIO4/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39, dhe [KI64/22](#), parashtrues *Vatani Shpk*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 shtatorit 2022, paragrafi 77).
94. Thënë këtë, Gjykata konstaton se pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës, në baza kushtetuese duhet deklaruar qartazi të pabazuar në kategorinë e pretendimeve *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*, siç përcaktohet me nenin 48 të Ligjit dhe pikën (d) të paragrafit (1) dhe paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.




## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenet 20, 47 dhe 48 të Ligjit, pikën (d) të paragrafit 1 dhe paragrafin (2) të rregullit 34 dhe pikës b) të paragrafit (1) të rregullit 48 të Rregullores së punës, më 30 tetor 2024,

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit; dhe
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit

**Gjyqtari raportues**



Nexhmi Rexhepi



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Gresa Caka-Nimani